



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA KOLONJË

---

## RELACION TEKNIK ARKITEKTUROR

### **RELACIONI ARKITEKTONIK PËR PROJEKTIN: "TERRENET SPORTIVE TE SHKOLLES "JANI VRETO" LESKOVIK"**

#### **I. PERSHKRIM I PERGJITHSHEM**

SHKOLLA E MESME E PERGJITHSHEME "JANI VRETO" LESKOVIK,  
KOLONJE.

Shkolla e mesme e pergjithshme e Leskovikut mban emrin e nje prej rilindesave nder me te shquar Kolonjare Jani Vretos nga fshati patriotik i Postenanit. Kjo ikone e diturise e ka nderuar emrin e madh e te ndritur te ketij veprimtari te madh te rilindjes mbare shqiptare ku nga bangat e saj ka nxjere dhjetra e qindra intelektuale te zot te cilet sherbejne ne institucione te ndryshme shteterore si dhe ndermarje te medha private brenda e jashte vendit

## II. POZICIONI I OBJEKTIT NE PROJEKT

Projekti parashikohet të ndërtohet ne qytetin e Leskovikut, Bashkia Kolonjë, në shkollën aktuale “Jani Vreto”.



## III. SITUATA EKZISTUESE E ZONES

Zona ku parashikohet të rindërtohet terrenet sportive, është zone sportive pranë shkolles ne qender te qytetit. Objekti dhe fusha pozicionohen ne buze te rruges hyrese veriore te qytetit. Nga pikepamja topografike fushat ndodhen në një terren të thelluar , për të krijuar sheshin e nevojshem për fushat.




#### IV. FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE







## V. PLANVENDOSJE



## VI. TE DHENA TEKNIKE

Projekti i paraqitur parashikon ndërtimin e fushave sportive për shkollën “Jani Vreto” Pozicioni i këtyre fushave nuk ndikon vetëm te shkolla por te i gjithë qyteti i Leskovikut. Fushat që propozohen jane:

- Një fushë basketbolli me përmasa 28m x 15m (hapsira e lojës) dhe një perimetër rreth saj prej 2m. Ky perimetër është i domosdoshëm për mbarëvajtjen e lojës. Fusha në anën verilindore të saj propozohet të ketë shkallare të pajisur me stola plastikë për uljen e spektatorëve.
- Një fushë minifutbolli me përmasa 25m x 16m (hapsira e lojës) dhe një perimetër rreth saj prej 2m. Fusha në anën jug-perëndimore të saj ka një shkallare prej betoni shkallare të pajisur me stola plastikë për uljen e spektatorëve.
- Një fushë volebolli që është në mes të dy fushave të mëdha.
- Në jugperëndim të sheshit parashikohet një pistë e vogël vrapimi dhe në mes të saj vegla të ndryshme gjimnastikore.

Ark. Klodian BURGJIA